

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ORLANDO SH.P.K IMPORT&EXPORT CONSERVE ITTICHE” Sh.p.k

Sot me datë 16 .02. 2018 ortaku i vetëm:

SALVATORE ORLANDO i lindur me 26.03.1960 në Trappeto, Itali dhe banues në Shqipëri, madhor, me zotesi te plota juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me ane te Pasaportës me Nr.AA5927333 ;

në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe mbështetur ne Ligjin me Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” ndryshuar me Ligjin nr.10475 dt.27.10.2011 dhe me ligjin nr.129/2014 si dhe në Ligjin me Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” ndryshuar me ligjin Nr. 9916 dt.12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 themeloi shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar « ORLANDO SH.P.K IMPORT&EXPORT CONSERVE ITTICHE » Sh.p.k me kushtet e mëposhtme :

Neni 1

Emri

Themeluesi do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila do të quhet « ORLANDO SH.P.K IMPORT&EXPORT CONSERVE ITTICHE » Sh.p.k


Neni 2

Selia

Shoqëria « ORLANDO SH.P.K IMPORT&EXPORT CONSERVE ITTICHE » Sh.p.k do e ka selinë në ne Elbasan në Lagjen 5 Maj, në Rrugën Mahmut Biçaku, Pallati 747, Shkalla 3,Kati 3, Apartamenti nr.5.

Neni 3

Kohëzgjatja



Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë e pacaktuar, ajo mund të shpërndalet edhe me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë, si dhe kur merr fund aktiviteti i saj apo kur shpërndarjen e saj e përcakton ligji.

Neni 4

Organet drejtuese

Si organ drejtues i Shoqërisë është:

Ortaku i vetëm i saj i cili është dhe administratori.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

-Shitje me shumice e produkteve me origjine shtazore,

-Import - eksport i të gjitha produkteve me origjine nga deti si dhe të akuakultures si të gjitha llojet e peshkut dhe nënproduktet e tij, të gjitha llojet e guackave, të gjitha llojet e specieve me origjine detare në gjendje të fresketa, të ngrira, të kripura, të marinuara në vaj, në salcë, në vakum, të konservuara etj,

-Import-eksport i produkteve agrikutures fruta perime si të fresketa dhe të konservuara, import eksport i materialeve të ndertimit, makineri dhe pajisje.

-Fasoneri ose regjim të perpunimit aktiv.

-Perpunim dhe konservim të produkteve me origjine detare.


E gjithë veprimtaria e saj bazohet në ligjet që janë në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është 100.000 lekë (njëqind mijë lekë).

Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Ortakut të saj të vetëm.



Neni 7

Baza ligjore

Shoqëria përveç këtij akti themelimi bazohet do të rregullohet edhe me normat e përcaktuara në Statut si dhe në legjislacionin të Republikës së Shqipërisë konkretisht në baze të Ligjit me Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ndryshuar me Ligjin nr.10475 dt.27.10.2011 dhe me ligjin nr.129/2014 si dhe në bazë të Ligjit me Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit” ndryshuar me ligjin Nr. 9916 dt.12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015.

Neni 8

Dispozita të fundit

Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës përcaktohen nga Ortaku i Shoqërisë.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe dhe italisht duke patur secila kopje fuqi të njëjtë ligjore.

THEMELUESI

SALVATORE ORLANDO

